

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6895  
E hënë, 15 maj 2023  
Çmimi 0.40

## Erdogani bie nën 50 për qind, Turqia drejt balotazhit? | FAQE 2



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

RAMA I BINDUR SE PS-JA DO T'I FITOJË MBI 50 BASHKI, OPOZITA DOLI DOBËT

## RAMA I BINDUR SE PS-ja DO T'I FITOJË MBI 50 BASHKI, OPOZITA DOLI DOBËT | FAQE 2



Qytetarët e Shqipërisë votuan të dielën për kryebashkiakët e rinj që do të drejtojnë 61 bashkitë për katër vitet e ardhshme. Në këto zgjedhje Partia Socialiste e cila drejtohet nga Edi Rama del si

forcë kryesore fituese në zgjedhjet e 14 majit. Në tri bashkitë ku votimi u bë në mënyrë elektronike; në Elbasan, Kamëz dhe Vorë, fituan kandidatët e PS-së. Ndërkaq në bashkitë tjera po

vazhdon numërimi i votave, ku PS-ja prinë bindshëm. Edi Rama ka thënë se PS-ja do t'i fitojë mbi 50 bashki. Ndërkaq në këto zgjedhje opozita doli me rezultat të dobët

## YLFETE FANAJ, GRUAJA E PARË SHQIPTARE QË BËHET MINISTRE KANTONALE NË ZVICËR | FAQE 3



## AKOMODIMI PA KATEGORIZIM I TË BURGOSURVE | FAQE 5

### AKTUALE



## LAGËSHTI, RRJEDHJE UJI DHE MUNGESË HAPËSIRE NË BARNATOREN QENDRORE TË QKUK-së | F. 3

## EULEX-I NUK VËREN "NDRYSHIME NË TERREN" LIDHUR ME DYSHIMET PËR RIINSTALLIMIN E POLICISË SERBE NË VERI | F. 5

## OSMANI, KONJUFCA DHE KURTI PËRKUJTOJNË 24-VJETORIN E MASAKRËS NË QYSHK, ZAHAQ, LLABJAN DHE PAVLAN | F. 6

### EKONOMI



## KURTI PËR RAPORTIN E BANKËS BOTËRORE: KOSOVA KA ULUR SHKALLËN E VARFËRISË PËR 35 PËR QIND | F. 7

## NJË DITË PUSHIMI I KUSHTON ZVICRËS MBI 350 MILIONË EURO | F. 7

### SPORT



## BALLKANI RIKTHEHET NË POZITËN E LIDERIT | F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mbx: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

TË DIELËN U MBAJTËN ZGJEDHJET LOKALE NË SHQIPËRI

## Rama i bindur se PS-ja do t'i fitojë mbi 50 bashki, opozita doli dobët

Qytetarët e Shqipërisë votuan të dielën për kryebashkiakët e rinj që do të drejtojnë 61 bashkitë për katër vitet e ardhshme. Në këto zgjedhje Partia Socialiste e cila drejtohet nga Edi Rama del si forcë kryesore fituese në zgjedhjet e 14 majit. Në tri bashkitë ku votimi u bë në mënyrë elektronike; në Elbasan, Kamëz dhe Vorë, fituan kandidatët e PS-së. Ndërkaq në bashkitë tjera po vazhdon numërimi i votave, ku PS-ja prinë bindshëm. Edi Rama ka thënë se PS-ja do t'i fitojë mbi 50 bashki. Ndërkaq në këto zgjedhje opozita doli me rezultat të dobët

**EPOKA E RE**

Mal QORRAJ

**TI RANË, 14 MAJ** - Në Shqipëri, autoritetet zgjedhore kanë njoftuar se Partia Socialiste ka fituar garat për kryetar bashkie në Elbasan, Kamëz dhe Vorë.

Në këto tri bashki, votimi në zgjedhjet vendore të 14 majit u bë në mënyrë elektronike, duke mundësuar edhe publikimin më të shpejtë të rezultateve.

Kryeministri i Shqipërisë, njëherësh kryetar i PS-së, Edi Rama, ka thënë se fitorja e PS-së do të jetë e thellë në këto zgjedhje. Ai ka thënë se subjekti që drejton do t'i fitojë mbi 50 bashki, ndërsa opozita nga 0 deri në 11 bashki. Të dielën, qytetarët në Shqipëri votuan për zgjedhjen e 61 kryetarëve të rinj të bashkive dhe këshillave bashkiake. Rezultatet zgjedhore për bashkitë e tjera, ende nuk janë publikuar.

Sipas rezultateve, në Elbasan kandidati i PS-së, Gentian Llataj fitoi mandatin e dytë, duke mposhtur kundërkandidatin nga koalicioni "Bashkë Fitojmë", Luçiano Boçi.

Kamza do të drejtohet edhe për katër vjet nga socialisti Rakip Suli, i cili fitoi mbi 60 për qind të votave, duke mposhtur Arjan Hoxhën nga "Bashkë Fitojmë".

Në Vorë, me mbi 75 për qind të votave të fituara, socialisti Blerim

Shera mposhti rivalin nga opozita, Indrit Hoxha.

Qendrat e votimit u hapën në orën 07:00 dhe u mbyllën në orën 19:00. Në disa qendra, ku ka pasur radhë të qytetarëve, votimi ka vazhduar edhe pas orës 19:00.

Dalja në zgjedhje, sipas Komisionit Qendror të Zgjedhjeve deri në orën 18:00 ishte 36.39 për qind. Pjesëmarrja në këto zgjedhje konsiderohet e ulët. Pikërisht ky ka qenë apeli i krerëve të shtetit dhe politikanëve menjëherë pasi votuan.

Procesi i votimit është përcjellë me disa probleme teknike. Në disa qendra, votimi nisi me vonesë për shkak të mosfunksionimit të pajisjeve të identifikimit elektronik, ndërkohë në disa të tjera ka pasur probleme me paraqitjen e komisionarëve, kryesisht të Partisë Demokratike. Gjithashtu, në mbarë Shqipërinë u shfaqën probleme me pajisjet për identifikimin biometrik dhe për këtë arsye, kreu i KQZ-së, Ilirjan Celibashi, urdhëroi që identifikimi i votuesve të bëhet manualisht, përkatësisht përmes listës së votuesve.

Ambasadorja e Shteteve të Bashkuara në Tiranë, Yuri Kim, ajo e Bashkimit Evropian, Christine Hoffman, dhe kryesuesja e vëzhguesve të ODIHR, Audrey Glover, vëzhguan nga afër procesin e votimit në disa qendra.



Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, të drejtë vote në zgjedhjet e 14 majit kishin 3 milionë e 653 mijë persona. Prej këtij numri, 122.545 ishin votues të rinj.

Në garën për drejtimin e 61 bashkive ishin 144 kandidatë. Ndërkaq, për 1.603 ulëse në këshillat bashkiake garuan 23.700 persona.

Në zgjedhjet e 14 majit u regjistruan 40 parti dhe koalicione.

Në tri bashki, Kamëz, Vorë dhe Elbasan u votua në mënyrë elektronike.

Në pjesën më të madhe të bashkive gara zhvillohet mes Partisë Socialiste dhe koalicionit "Bashkë Fitojmë" që

drejtohet nga Sali Berisha dhe Ilir Meta, politikanë që në të kaluarën kanë mbajtur poste të larta drejtuese si kryeministër apo president i Shqipërisë.

Partia Demokratike, e cila drejtohet nga ushtruesi i detyrës, Enkelejd Alibeaj, kishte kandidatë vetëm në 14 bashki. Kjo për shkak të përçarjes së Partisë Demokratike, pas shpalljes "non grata" nga Shtetet e Bashkuara të ish-liderit të këtij subjekti, Sali Berisha.

### Berisha nuk e pranon rezultatin zgjedhor

Ish-kryeministri Sali Berisha në një komunikim për mediat e ka

cilësuar rezultatin në Kamzë të manipulueshëm. Berisha tha se "Bashkë Fitojmë" ka indicie se sistemi është vendosur në kontrolle të dyfishta. "Ky është absolutisht një rezultat i gatuar në mënyrë digjitale dhe hidhet poshtë me vendosmëri më të madhe. Shtoj këtu se Kamza është shtuar nga qeveria pa aprovimin e askujt dhe në kundërshtim me kërkesat për tu votuar në mënyrë digjitale. Edhe njëherë them se rezultati i Kamzës pasi u krahasuan rekordet elektorale dhe pollet, janë kryekëput të manipuluar. Kur them për Kamzën, atëherë problemi digjital është totalisht në diskutim dhe dyshim të plotë. Kamza faktom çdo gjë", ka thënë Berisha.

## Erdogani bie nën 50 për qind, Turqia drejt balotazhit?

Ankara, 14 maj- Të dielën në Turqi janë mbajtur zgjedhjet presidenciale dhe parlamentare. Mbështetja e votuesve për presidentin turk, Recep Tayyip Erdogan, ka rënë nën shumicën e kërkuar për të fituar zgjedhjet presidenciale në raundin e parë. Kjo rrit

gjasat që presidenti i ri i shtetit të zgjidhet në raundin e balotazhit të caktuar për 28 maj. Me pothuajse 91 për qind të votave të numëruara, Erdogan ka fituar 49.9 për qind të votave, sipas agjencisë shtetërore të lajmeve, Anadolul. Kundërkandidati i

tij kryesor, Kemal Kilicdaroglu, ka fituar 44.4 për qind të votave. Ndërkaq, agjencia Anka, që është e afërt me opozitën, ka raportuar se me 95 për qind të votave të numëruara, Erdogan ka fituar 49 për qind të votave dhe Kilicdaroglu 45 për qind.

**EPOKA E RE**

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere\_mm@hotmail.com &amp; mm\_epokaere@yahoo.com

## Çitaku thotë se qeveria Kurti po mashtron

PRISHTINË, 14 MAJ - Ish-ambasadorja e Kosovës në Uashington, aktualisht nënkryetare e PDK-së, Vlora Çitaku, ka reaguar ndaj qeverisë Kurti 2. Çitaku ka

parashtruar disa pyetje ndaj qeverisë për inflacionin dhe rritjen e çmimit të energjisë. "A jeton më mirë një qytetar i Kosovës sot se më parë? A e

përballon çmimin e rritur të energjisë elektrike? A arrin me pagën e njëjtë e pa rritje ta përballojë inflacionin?", ka shkruar Çitaku në "Facebook".

Çitaku është përgjigjur duke thënë se "ndoshta në universin paralel të Kurtit po. Por në botën reale jo". "Lërimi mashtrimet", ka shkruar Çitaku.



## Ylfete Fanaj, gruaja e parë shqiptare që bëhet ministre kantonale në Zvicër



**EPOKA E RE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 14 MAJ - Ylfete Fanaj është zgjedhur të dielën ministre kantonale, duke u bërë kështu e para shqiptare që i besohet një detyrë ekzekutive në Zvicër. Presidentja e Kosovës, Vjosa

Osmani, e ka uruar Fanajn për zgjedhjen e saj ministrja e parë kantonale me prejardhje nga Kosova, njëherësh gruaja e parë kosovare së cilës i besohet një detyrë ekzekutive.

Osmani ka thënë se Ylfetja është frymëzim për gratë e vajzat tona dhe dëshmi se me punë dhe përkushtim gjithçka

është e arritshme. "Në vitin 2021 pata kënaqësinë ta takoj znj. Ylfete Fanajn në cilësinë e kryetares së Parlamentit të Luzernit në Zvicër dhe ta përgëzoj për sukseset e saj prej vitesh në shtetin helvetik. Ajo dëshmoi zell dhe vendosmëri për përmirësimin dhe avancimin e politikave për të

gjitha komunitetet pa përjashtim. Sot kam kënaqësinë ta uroj me zemër që u bë ministrja e parë kantonale me prejardhje nga Kosova, njëherësh gruaja e parë kosovare së cilës i besohet një detyrë ekzekutive. Ylfetja është frymëzim për gratë e vajzat tona dhe dëshmi se me punë

dhe përkushtim gjithçka është e arritshme. Ajo është ndër përfaqësueset më të denja të mërgatës sonë, e cila është pjesë vitale e shtetit të Kosovës. E nderuar Ylfete, të prifshin sukseset dhe qofsh urë e fortë lidhëse e Republikës së Kosovës me Zvicrën!", ka thënë Osmani në deklaratën për medie.

## Sinani: Qeveria e Serbisë të mundësojë sa më parë fillimin e hetimeve mbi pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Serbi



PRISHTINË, 14 MAJ - "Qeveria e Serbisë të mundësojë sa më parë fillimin e hetimeve mbi pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Serbi. Këtë e kërkon tashmë zyrtarisht edhe Parlamenti Evropian", ka bërë me dije këshilltarja politike e kryeministrit Albin Kurti për Luginën e Preshevës, Ardita Sinani. Ajo ka treguar se në Raportin e sapomiruar të

Progresit për Serbinë, Parlamenti Evropian shpreh qartësisht nevojën urgjente për një hetim të pavarur dhe gjithëpërfshirës mbi akuzat për abuzimin e ligjeve të vendbanimit dhe diskriminimin me pasivizimin e adresave të shqiptarëve në Serbi. "Për më tepër, u bëhet thirrje autoriteteve të Republikës së Serbisë t'u japin fund të gjitha

praktikave diskriminuese ndaj minoriteteve dhe t'i zbatojnë marrëveshjet e fundit në kuadër të Procesit të Berlinit, pos të tjerash, edhe për njohjen e diplomave të Kosovës. Në shumë çështje, Raporti vërteton prirjet autoritariste të pushtetit në Serbi në shpërputhje me vlerat dhe politikën e jashtme evropiane", ka shkruar Sinani në "Facebook".

## Lagështi, rrjedhje uji dhe mungesë hapësire në barnatoren qendrore të QKUK-së

PRISHTINË, 14 MAJ - Hapësirat e barnatores qendrore të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës janë të ngushta dhe të

papërshtatshme për të punuar. Aty nuk ka zyra të mjaftueshme për farmacistët dhe stafin përcjellës. Në dhomat ku

janë të sistemuara barnat janë të vendosura edhe tavolinat e punës për stafin. "Radio Evropa e Lirë" ka publikuar pamje brenda

ambienteve të barnatores, ku shihet se ka lagështi dhe rrjedhje të ujit nga gypat e ujit, të ujërave të zeza dhe të ngrohjes.





# Akomodimi pa kategorizim i të burgosurve

**PRISHTINË, 14 MAJ** - Vendosja e të burgosurve të kategorive të ndryshme në pavijone të njëjta të burgjeve të Kosovës është një prej problemeve që duhet adresuar me urgjencë, thonë përfaqësues të organizatave që merren me të drejtat e njeriut.

Një raport që ka publikuar Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT) në fillim të këtij muaji ka gjetur se të burgosurit me probleme të shëndetit mendor dhe përdoruesit e substancave narkotike vendosen dhe trajtohen në pavijone të njëjta me të burgosurit e tjerë, përfshirë të moshuarit dhe ata me sëmundje kronike.

Ky akomodim, sipas QKRMT-së, paraqet "trajtim të padinjitetshëm". Drejtoresha ekzekutive e kësaj organizate, Feride Rushiti, thotë se ai është në kundërshtim edhe me dispozitat ligjore në fuqi, sidomos për të paraburgosurit. "Menaxhimi i këtyre kategorive të të burgosurve me të burgosurit e tjerë është i vështirë edhe për stafin e qendrave korrektuese. Kjo përzierje e të burgosurve sjell shumë herë konflikte dhe dhunë mes të burgosurve", thotë Rushiti

për "Radion Evropa e Lirë".

Në shumicën e rasteve të dhunës mes të burgosurve, sipas gjetjeve të QKRMT-së, janë të përfshirë të burgosurit me probleme mendore dhe të burgosurit e varur nga substancat narkotike. Sipas Rushitit, rastet e tilla evidentohen më shpesh në Qendrën Korrektuese në Dubravë, në Burgun e Sigurisë së Lartë, në Qendrën e Paraburgimit në Prishtinë dhe në atë të Gjilanit. Për këtë situatë, vërejtjen e ka tërhequr edhe Avokati i Popullit në Kosovë, i cili ka kërkuar nga autoritetet përgjegjëse që ta adresojnë çështjen.

Sipas të dhënave të këtij institucioni për vitin 2022, në qendrat korrektuese dhe në ato të paraburgimit në Kosovë janë trajtuar 218 raste me çrregullime mendore dhe 226 me sëmundje kronike - prej tyre 50 persona kanë qenë mbi moshën 65-vjeçare dhe katër persona me nevoja të veçanta.

E njëjta problematikë është theksuar edhe në raportin e Departamentit amerikan të Shtetit për të Drejtat e Njeriut të publikuar vitin e kaluar. "Për shkak të mungesës së hapësirës, të burgosurit me çrregullime

mendore akomodohen me popullatën e përgjithshme të burgjeve", është thënë në pjesën për Kosovën të këtij raporti.

## Qendër e veçantë për trajtimin e disa kategorive të të burgosurve

Ministria e Drejtësisë e Kosovës qysh në vitin 2021 ka iniciuar procedurën për rregullimin e Pavijonit D të Qendrës Korrektuese në Dubravë si objekt i veçantë për akomodimin dhe trajtimin e këtyre kategorive të të burgosurve.

Zëvendësi i drejtorit të përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës, Ismail Dibrani, thotë për "Radion Evropa" se ky objekt do të vihet në funksion së shpejti, por nuk specifikon më shumë. Ai nuk jep detaje as rreth kapaciteteve që do t'i ketë ky pavijon apo kushteve të tjera përcjellëse.

## Keqtrajtime të të burgosurve

Përveç problematikës së akomodimit, raporti i QKRMT-së

veçon edhe "keqtrajtimin e të burgosurve" nga stafi i qendrave korrektuese.

Një i burgosur, sipas QKRMT-së, ka deklaruar se "zyrtarët korrektues e kanë goditur me shufra gome disa herë" derisa "e kanë lëshuar këmbët dhe ka rënë përtokë". Për këtë gjetje, REL-i pyeti Dibranin nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, i cili tha se në momentin kur institucioni e ka marrë këtë informacion nga QKRMT-ja, ai ka vënë në funksion komisionet hetuese. Sipas Dibranit, ekipet hetimore në këtë rast kanë konstatuar se përdorimi i forcës "ka qenë në proporcion me reagimin e të dënuarit". "Mjetet që janë theksuar se janë përdorur në këtë rast, si shufrat e gomës, ka vite që janë larguar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës", thotë Dibrani. Sipas tij, vërejtjet që bëjnë organizatat që merren me monitorimin e burgjeve - qoftë QKRMT-ja, Avokati i Popullit apo Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë - adresohen me kohë. "Në asnjë rrethanë ne nuk i shohim si pengesë, por si partnerë strategjikë për krijimin e një klime të mirë brenda institucioneve korrektuese", thotë Dibrani.

## Shala: Pak përmirësime në Qendrat Korrektuese

Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut në Kosovë thotë se përmirësimi i të drejtave të njeriut në burgjet e Kosovës është duke ecur me hapa të vegjël. "Ashtu siç i kemi kushtet e këqija në aspektin e respektimit të të drejtave të njeriut jashtë, ashtu janë edhe brenda burgjeve", thotë drejtori i këtij këshilli, Behxhet Shala.

Një prej vërejtjeve kryesore të KMDLINJ-së, sipas tij, lidhet me motivimin e të burgosurve - ata nuk motivohen që me sjellje të mirë të mund të përfitojnë diçka. "Nuk mund të kërkonim të ketë sjellje të mirë një i burgosur nëse nuk e motivoni", thotë Shala për "Radion Evropa e Lirë".

Sipas të dhënave të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në 11 qendrat e tij në Kosovë janë aktualisht mbi 1 800 persona, prej këtyre mbi 1 000 në vuajtje të dënimit, ndërsa pjesa tjetër të paraburgosur.

QKRMT-ja ka gjetur se në shumë prej tyre ka pasur, mes të tjerash, edhe probleme me ngrohjen, ushqime me afat të skaduar dhe mungesa terapistësh.

## EULEX-i nuk vëren “ndryshime në terren” lidhur me dyshimet për riinstalimin e policisë serbe në veri

PRISHTINË, 14 MAJ - Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë (EULEX) tha se nuk ka vërejtur ndonjë ndryshim në veri sa iu përket dyshimeve se Serbia po rihap zyrat e saj të Ministrisë së Punëve të Brendshme në katër komunat në veri të shtetit, të banuara me shumicë serbe. Sipas këtyre të dhënave, në katër komuna të veriut të Kosovës që nga 11 maji i këtij viti janë vendosur zyrat e MPB-së së Serbisë, të cilat kanë qenë funksionale deri në vitin 2013. Selia kryesore e MPB-së serbe, sipas informacioneve të këtij institucioni të sigurisë së Kosovës, do të jetë në Zvečan afër Shkollës Filllore “Vuk Karaxhiq”.

se Serbia po tenton t'i rihapë zyrat e Ministrisë së Punëve të Brendshme të saj në katër komunat në veri të shtetit, të banuara me shumicë serbe.

Sipas këtyre të dhënave, në katër komuna të veriut të Kosovës që nga 11 maji i këtij viti janë vendosur zyrat e MPB-së së Serbisë, të cilat kanë qenë funksionale deri në vitin 2013. Selia kryesore e MPB-së serbe, sipas informacioneve të këtij institucioni të sigurisë së Kosovës, do të jetë në Zvečan afër Shkollës Filllore “Vuk Karaxhiq”.

Serbia ka pasur strukturat e saj të sigurisë në Mitrovicë të Veriut, Zvečan, Zubin Potok dhe Leposaviq deri në vitin 2013. Por, pas marrëveshjes së arritur në dialogun e Brukselit, ato u integruan në institucionet e Kosovës, kryesisht në Policinë e Kosovës. Mirëpo, pothuajse të gjithë pjesëtarët e Policisë së Kosovës nga komuniteti serb dhanë dorëheqje në nëntor të vitit të kaluar, duke kundërshtuar vendimin e Qeverisë së Kosovës për rirregjistrimin e veturave që qarkullojnë në veri me tabela që i lëshon Serbia.

Serbia e mbështeti këtë veprim dhe në këmbim u dha të gjithëve kontrata me paga të njëjta siç i kishin marrë nga institucionet e Kosovës.


Të dhënat e siguruar nga REL-i tregojnë se të njëjtat zyra do të hapen edhe në Leposaviq dhe Zubin Potok, po ashtu edhe në objektet e përdorura më parë nga MPB-ja e Serbisë.

Gjithashtu, prania e MPB-së së Serbisë është planifikuar edhe në Rudarë afër Zveçanit.

As Ministria e Punëve të Brendshme të Kosovës, as Qeveria e Kosovës nuk i kanë

komentuar për këto pretendime. Përgjigje për REL-in nuk kanë kthyer as Agjencia e Informacionit të Serbisë (BIA) dhe Ministria e Brendshme serbe.

Ndryshe Lista Serbe, partia kryesore e serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit dhe autoritetet serbe, kanë thënë se kusht për kthimin e serbëve në institucionet e Kosovës është themelimi i Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe dhe tërheqja e njëjësive speciale të Policisë së Kosovës nga katër komunat në veri.



## Totaj e quan të pakuptimtë deklaratën e Kurtit për raportet qeveri-komuna

Prizren, 14 maj - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, në mbledhjen e qeverisë që u mbajt të mërkurën, njoftoi se javën e ardhshme do të mbahet një takim me kryetarët e komunave. “Javën tjetër do ta mbajmë takimin e radhës të përbashkët me kryetarët e komunave, të katërtin deri më tani, me qëllim mirëmbajtjen e komunikimit mes nivelit qendror dhe atij lokal dhe për të diskutuar për çështjen me interes për qytetarët”, ka theksuar Kurti.

Në këtë takim përfaqësim do të ketë edhe komuna e Prizrenit. Kryetari i kësaj komune, Shaqir Totaj, nuk tregoi nëse do të shkojë ai vetë



apo dikush tjetër nga kabineti i tij.

Ndër të tjera, të mërkurën Kurti i akuzoi komunat se po përdoren për t'i bërë opozitë pushtetit qendror. “Dikur niveli qendror i bënte opozitë qeverisjes lokale, sot qeverisja lokale në disa raste po përdoret për opozitë të nivelit qendror. Gabim ka qenë atëherë, gabim është edhe tani. Bashkëpunimin e kemi përgjegjësi. Qeveria është e të gjithëve, edhe e komunave, e komunat janë të qytetarëve, jo të partive politike”, ka deklaruar ai.

Këtë deklaratë të Kurtit, Totaj e ka quajtur të pakuptimtë sepse, sipas tij, qeverisja lokale dhe qendrore duhet të

jenë partnere dhe jo rivale. “Qeverisja qendrore dhe lokale janë, ose të paktën do të duhej të ishin, partnere e jo rivale, prandaj është e pakuptimtë kjo deklaratë sepse pushteti nuk mund t'i bëhet opozitë pushtetit”, ka thënë ai për “Express”.

Totaj ka treguar edhe se për çfarë tema do të diskutojnë në takimin me kryeministrin. Ai ka theksuar se do ta kërkojnë zhblokimin e mjeteve vetjake të komunave. “Do t'i diskutojmë çështjet e tatimit në pronë dhe faljen e 100 eurove që planifikon qeveria, çështjen e bartjes së mjeteve vetjake dhe çështje të tjera me interes për qytetarët”, ka deklaruar Totaj.

## "Kthesa" vë në pranga një person, i sekuestrohen mbi 25 kilogramë drogë

**MITROVICË, 12 MAJ** - Nën kryetari i komunës së Mitrovicës, Arian Tahiri, së bashku me drejtorin për Siguri dhe Emergjencë, Bahtir Maxhuni, pritën në takim përfaqësuesit e prindërve të fëmijëve të Organizatës Joqeveritare "Handikos". Të pranishmit nga

përfaqësuesit komunalë kërkuan mbështetje institucionale si dhe ofrimin e kushteve më të mira për fëmijët me nevoja të veçanta në mënyrë që të ndihen të barabartë në shoqëri. Me këtë rast, nënkryetari Tahiri ofroi gatishmëri për

mbështetjen e kësaj kategorie të shoqërisë sonë, duke theksuar përkrahjen e dhënë nga komuna për organizata të cilat mbrojnë të drejtat e personave me nevoja të veçanta, qoftë me projekte apo përmes ofrimit të kushteve dhe integritit të tyre në shoqëri.



OSMANI, KONJUFCA DHE KURTI PËRKUJTOJNË 24-VJETORIN E MASAKRËS NË QYSHK, ZAHAQ, LLABJAN DHE PAVLAN

# Para 24 vjetëve forcat e armatosura të Serbisë vranë mbi 120 shqiptarë civilë në Qyshk, Zahaq, Pavlan dhe Llabjan



**EPOKA E RE**

**Faton DËRMAKU**

**PRISHTINË, 14 MAJ** - Presidentja Vjosa Osmani ka përkujtuar 24-vjetorin e masakrës në Qyshk, Zahaq, Llabjan dhe Pavlan. Ajo ka theksuar se 24 vjet më parë në Qyshk, Zahaq, Llabjan dhe Pavlan forcat e regjimit gjenocidal serb vranë e masakruan barbarisht 44 civilë në Qyshk, 17 në Zahaq, 21 në Pavlan dhe 13 në Llabjan. "Ata u vranë në vatrat e tyre shëkullore dhe janë dëshmi e fuqishme e krimeve serbe në Kosovë. Ne do t'i kujtojmë përherë ata, sikurse nuk do të ndalemi asnjëherë në kërkim të drejtësisë për t'i dhënë

kuptim lirisë sonë. Qoftë i përhershëm kujtimi për martirët e Qyshkut, Zahaqit, Llabjanit e Pavlanit!", është theksuar në deklaratën e presidentes Osmani. Kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, ka thënë se këta martirë janë pjesë e gjithë atyre të rënëve që e paguan lirinë dhe pavarësinë me jetën dhe sakrificën e tyre. "Nderimi ndaj tyre është njëkohësisht zotim për të mos reshtur përpjekjet e përparimit në çdo sferë, duke përfaqëuar aspiratën që e trashëgojmë prej tyre dhe në emër të sakrificës së tyre sublime. Liria që ata mundësuan i bën martirë të paharrueshëm, por krimet ndaj

tyre dhe kriminelët serbë që kryen akt gjenocidi dhe krime kundër njerëzimit ende nuk janë ndëshkuar. Në kohën kur Republika e Kosovës i nderon të rënë për liri, Serbia mbron kriminelët e saj, për ta fshehur të vërtetën e saj gjenocidale", ka shkruar Konjufca në "Facebook". Ai ka thënë se përkushtimi i tyre do jetë gjithnjë i pandalshëm deri kur liria që erdhi të sjellë edhe drejtësi për të gjithë të masakruarit e regjimit serb në Kosovë, drejtësi që vjen përmes ndëshkimit të krimeve makabre të Serbisë, përmes ndëshkimit ndaj atyre që planifikuan, urdhëruan dhe zbatuan gjenocidin dhe

krimet kundër njerëzimit në Kosovë. Ndërkaq kryeministri Albin Kurti bëri homazhe te varret e këtyre martirëve. "Në mëngjesin e hershëm të 14 majit 1999, në mes të fushatës ajrore të NATO-s kundër ish-Jugosllavisë, forcat e armatosura të Serbisë hynë në fshatin Qyshk. Ishin rreth 100 pjesëtarë të armatosur, me fytyra të mbuluara me ngjyrë të zezë ose maskë, dhe disa prej tyre kishin në kokë shalla të zinj dhe kapele të gjelbra të stilit kauboj. Mes tyre ishte edhe grupi i quajtur 'Çakallët'. Ata dëbuan me dhunë banorët nga shtëpitë. I mblodhën në qendër të fshatit, ua grabitën

paratë dhe stolitë e arit. Ua grisën dhe dogjën dokumentet e identifikimit personal. Pastaj i ndanë burrat nga gratë dhe fëmijët. Burrat i dërguan në tri shtëpi, i pushkatuan dhe pastaj i dogjën", ka thënë Kurti. Kurti ka thënë se sistemi ynë i drejtësisë duhet të angazhohet për drejtësi për viktimat dhe gjykim e dënim të kriminelëve të luftës dhe urdhërdhënësve të tyre. "Krimet e Serbisë të kryera gjatë luftës në Kosovë nuk mund të falen e as harrohen. Proceset e rralla e të pakta gjyqësore në Serbi ishin tallje me viktimat dhe shpëlarje kriminelësh", ka thënë Kurti.

## Peci kërkon reagim nga Prokuroria: Të kujt janë këto vila në Rugovë?

**PRISHTINË, 14 MAJ** - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë të dielën se Prokuroria nuk është duke treguar se nga kush janë duke u ndërtuar vilat në Stankaj të Rugovës që, sipas tij, ndërtimi tyre është në tokën e shtetit. "Çile guri gojën prokuroria... Mediave po ju ikë ky lajm...Të kujt janë këto villa

dhe pse po heshtet. Po, duke heshtë bash si këto villat e gurit në Stankaj të Rugovës, të ndërtuara në tokë të shtetit bash nga ata që për mandat kanë pasur ruajtjen e tokës dhe pronës shtetërore e jo keqpërdorimin e saj", ka shkruar Peci në "Facebook". Tutje thotë se këto raste i ka denoncuar para shtatë

muajve dhe, sipas tij, Prokuroria nuk ka bërë asnjë veprim. "7 muaj kanë kaluar prej se kam denoncuar publikisht këto zuzurpime dhe asnjë reagim, asnjë veprim i ndërmarrë... Për të tilla denoncime duhet reaguar brenda 24 orëve besoj unë...", ka shkruar ministri Peci.



## Kurti për raportin e Bankës Botërore: Kosova ka ulur shkallën e varfërisë për 35 për qind

PRISHTINË, 14 MAJ - Kryeministri Albin Kurti ka thënë se, krahasuar me 10 vjet më parë, Kosova ka ulur shkallën e varfërisë për 35 për qind. Kurti, duke komentuar raportin e Bankës Botërore, është shprehur se janë rritur për 50 për qind të ardhurat për kokë banori. "Lavdërime të larta për Kosovën nga Banka Botërore këtë javë. Sipas këtij institucioni, krahasuar me 10 vjet më parë, Kosova ka rritur të ardhurat për frymë për 50 për qind dhe ka ulur shkallën e varfërisë për 35 për qind, duke tejkuluar vendet

e njëjta me të ardhura të ngjashme për frymë", ka shkruar Kurti në "Twitter". Po sipas BB-së, brenda dekadës së fundit vendi ynë ka shënuar përparim të qëndrueshëm ekonomik. "Gjatë dekadës së fundit Kosova ka shënuar përparim të qëndrueshëm ekonomik, me rritje rreth 50 për qind të të ardhurave për frymë dhe ulje prej 35-përqindësh të shkallës së varfërisë", thekson raporti. Ajo ka kryer me sukses tranzicionin nga modeli i rritjes së bazuar në varësi të lartë nga flukset hyrëse të ndihmës së

huaj, duke lënë pas vendet homologe me të ardhura të ngjashme për frymë falë zgjerimit të vazhdueshëm të konsumit dhe investimeve, me shtysë të fortë nga flukset hyrëse të diasporës, investimet publike në infrastrukturë dhe thellimi financiar, në kushtet e një gjendjeje të qëndrueshme fiskale dhe një mjedisi me inflacion të ulët", ka theksuar BB-ja. Megjithatë, përkundër një dekade përparim, Banka Botërore thekson se papunësia dhe varfëria mbeten të larta.



## Peci: Dikur nevojiteshin 30 ditë për ta kompletuar dokumentacionin për subvencione, këtë vit duhen vetëm dy orë



ISTOG, 14 MAJ - Ministri i Bujqësisë, Faton Peci, ka thënë se në të kaluarën një fermeri i janë nevojitur 30 ditë për ta kompletuar dokumentacionin, derisa këtë vit duhen vetëm dy orë. Peci këto komente i ka bërë gjatë vizitës te një fermer në Istog. "Për aplikim për subvencione, Gjonit [Musolli] në të kaluarën i nevojiteshin 30 ditë për ta kompletuar dokumentacionin e

kërkuar, ndërsa këtë vit atij iu deshën vetëm dy orë", ka shkruar Peci në "Facebook". Ai ka thënë se Gjon Musollive primtarinë kryesore e ka blegtorinë, i cili mbarështon rreth 500 dele e qengja dhe 70 krerë lopë. Këtë vit do të ketë 100 % kontroll në terren, me qëllim që përfituesit e vetëm të jenë fermerët meritorë dhe realë", ka bërë me dije ministri Peci.

Gjon Musolli, përveçse me blegtori, punon edhe rreth 200 hektarë tokë nga të cilat 80 hektarë me grurë, 85 hektarë me misër, ndërsa të tjerat me jonxhë. "Takimi me Gjonin më la përshtypje pozitive pasi që ai është një nga fermerët më të vyeshëm jo vetëm të Istogut, por edhe të Kosovës", ka thënë ministri Peci.

## Një ditë pushimi i kushton Zvicrës mbi 350 milionë euro

BERN, 14 MAJ - Javën e kaluar Parlamenti federal i Zvicrës votoi në favor të shtimit të një feste publike vjetore për ta festuar demokracinë. Këtë javë Sekretariati Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO) tha se dita shtesë e pushimit do t'i kushtonte ekonomisë 350 milionë franga [356 milionë euro]. Kjo shumë është llogaritur duke krahasuar Prodhimin e Brendshëm Bruto në vitet kur Krishtlindjet bien të dielën me

vitet kur nuk bien. Megjithatë, kostoja nuk bie në mënyrë të barabartë për të gjitha bizneset. Një shitës me pakicë që detyrohet të mbyllet për një ditë mund të bëjë një llogaritje të thjeshtë të koston, megjithëse nuk është e qartë nëse shitjet e humbura janë të humbura ose të shtyra. Bizneset me cikle më të gjata faturimi do ta kenë më të vështirë llogaritjen e humbjes. Është e vështirë për ta llogaritur kundërgargumentin e

produktivitetit më të lartë pas një dite pushimi. Kjo mund të ketë kuptim për punën që ka të bëjë më shumë me frymëzim sesa me djersë. Është e vështirë të imagjinohet dikush duke kositur lëndina për jetesën duke rritur ritmin e kositjes mjaftueshëm në ditët pas pushimit për të kompensuar një ditë të humbur. I vetmi sektor që ndoshta mund të jetë i sigurt se do të përfitojë nga një pushim shtesë është turizmi.



## Sanksione të reja nga BE-ja dhe G7-ta për gazin rus

BRUKSEL, 14 MAJ - Bashkimi Evropian dhe grupi i shtatë vendeve më të zhvilluara (G7) synojnë ta ndalojnë rifillimin e transportit të gazit nga Rusia. Siç shkruan "Financial Times", do të jetë hera e parë që vendet perëndimore ndalojnë transportin e gazit përmes tubacioneve të gazit nga Rusia që nga fillimi i luftës në Ukrainë. Vendimi pritet të bëhet zyrtar javën e ardhshme në samitin e liderëve të G7-s në Hiroshima dhe do ta parandalojë rifillimin e furnizimit me gaz natyror nga Rusia në vende si Polonia dhe Gjermania të cilat Rusia i ka shkëputur më parë furnizimet. Vendet perëndimore duan ta pengojnë Rusinë që t'i rrisë të ardhurat e saj nga eksportet e energjisë. Po ashtu, kjo lëvizje duhet të "sigurojë që partnerët



të mos ndryshojnë mendje në një të ardhme hipotetike". Në projektvendimin e G7-s thuhet se qëllimi është të

zvogëlohet më tej varësia nga burimet ruse të energjisë "përfshirë rihapjen e flukseve të mbyllura më parë nga Rusia,

e cila përdorte energjinë si armë, të paktën deri në zgjidhjen e konfliktit". Që nga fillimi i luftës BE-ja ka

shmangur masat që synojnë tubacionet e gazit për shkak të varësisë së saj të lartë nga gazin rus. Nga ana tjetër, Rusia pezulloi furnizimet përmes disa tubacioneve të gazit, gjë që shkaktoi një rritje enorme të çmimit. Në muajt e fundit çmimet e gazit kanë rënë ndjeshëm për shkak të rënies së kërkesës gjatë dimrit, përshtypimit të ndërimit të burimeve të rinovueshme dhe importit të LNG-së. Si rezultat, pjesa e gazit rus në importet e BE-së ra nga mbi 40 për qind në rreth 10 për qind. Gjithashtu, depozitat evropiane të gazit janë aktualisht me kapacitet rreth 60 për qind krahasuar me vetëm rreth 30 për qind në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

# Një negociator i Harvardit shpjegon si duhet të debatojmë

Debatet janë një pjesë e domosdoshme e jetës, por ato nuk duhet të jenë domosdoshmërisht të ngarkuara.

Psikologu Dan Shapiro ka identifikuar tre barriera për debatet produktive: identiteti ne-kundër atyre, mos vlerësimi dhe një mungesë përkatësie. Thyerja e këtyre barrierave kërkon që të jemi dëgjues më të mirë dhe të rikategorizojmë ndjenjën tonë që kemi për “ne”

Shumica e njerëzve duan që debatet të jenë konstruktive. Ata shqetësohen se politika është bërë shumë e polarizuar dhe se mediat sociale janë fushëbeteja më toksike e luftërave kulturore. Dhe në jetën e tyre personale, shqetësohen kur marrëdhëniet premtuese kanë vështirësi për të kapërcyer mosmarrëveshjet e rrënjosura.

Edhe Dan Shapiro, një ekspert për negociatat dhe zgjidhjen e konflikteve në Universitetin e Harvardit, e sheh konfliktin të papëlqyeshëm. Por siç thoshte ai në një intervistë, debatet janë një përvojë universale njerëzore. Ne nuk mund t'i shmangim dhe nëse i injorojmë, është në dëm tonë. Pavarësisht se sa mund të mos na pëlqejë, duhet të jemi në gjendje të përfshihemi në debatet e jetës, pavarësisht nëse zgjidhen në favorin tonë apo jo. Problemi nuk është se ne kemi debate. “Problemi është se si.”

Në kërkimin dhe përvojën e tij, Shapiro ka identifikuar tre barriera që duhet të kapërcejmë për të pasur debate më të mira dhe më produktive.

## Barriera e parë:

### Një identitet ne – kundër atyre

Qëllimi i një debati ndryshon në momentin që identiteti juaj ngatërrohet në konflikt. Në atë pikë, ju nuk po përpiqeni më të zgjidhni një mosmarrëveshje ose të ballafaqoni idetë konkurruese. Po luftoni për ndjenjën që keni për vetveten. Tani je ti (si individ) ose ne (si fis) kundër atyre. Pasi të jeni në atë gjendje vetëmbrojtjeje, emocionet bëhen më të fuqishme dhe dëshira juaj për të gjetur gjuhën e përbashkët ia lë vendin nevojës për të fituar.

Fatkeqësisht, është tmerrësisht e lehtë që debatet të kalojnë në një sfidë “ne kundër atyre”. Në fakt, ndërsa ne bashkëpunojmë me anëtarët e grupit tonë, jemi gjithashtu natyrshëm fobikë jashtë grupit. Studimet tregojnë se kur njerëzit identifikohen fuqishëm me një ideologji, ata mund ta çnjerëzojnë grupin deri në pikën e nënvlerësimit të aftësisë së tyre për të patur ndjesitë themelore njerëzore, të tilla si etja dhe të ftohtit. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa t'i atribuojnë motivimet e palës

tjetër si të liga dhe të urryera.

Ky është më shumë se arsytim i dobët nga ana jonë. Mentaliteti ne-kundër atyre ka një bazë neurologjike në hormonin oksitocinë.

Oksitocina zakonisht vlerësohet si një hormon pro-social. Është një kontribuese e rëndësishme në sjellje të tilla si ndërtimi i besimit, rritja e bashkëpunimit dhe kujdesi social. Na bën më shprehës emocionalisht dhe përmirëson inteligjencën tonë emocionale. Madje i ndihmon nënën të lidhen me foshnjat e tyre dhe çiftet me njëri-tjetrin. Por studimet kanë treguar gjithashtu se oksitocina nuk është vetëm një hormon mbështetës. I njëjti hormon që nxit kohezionin brenda grupit mund të forcojë gjithashtu konkurrencën jashtë grupit. Ky rol i dyfishtë i të bërit dashuri dhe luftë quhet “paradoksi i oksitocinës”.

Siç e thekson Shapiro: “Duhet të dini se kush jeni dhe çfarë përfaqësoni. Cilat janë vlerat dhe besimet që më shtynë të luftoj për këtë qëndrim për këtë çështje? Sa më shumë të kuptoni se kush jeni, aq më shumë mund të përpiqeni të arrini qëllimin tuaj dhe të qëndroni të ekuilibruar, edhe kur tjetri kërcënon ato vlera dhe besime thelbësore.”

Sigurisht, askush nuk është i përsosur. Ne të gjithë do të humbasim ekuilibrin herë pas here.

## Barriera Nr. 2: Të mos tregosh vlerësim

Pasi të shohim se si identiteti luan në mbrojtjen tonë emocionale, mund të punojmë për t'i ulur ato gardhe tek ne dhe tek të tjerët. Një mënyrë për ta bërë këtë dhe për të ndërtuar një lidhje më të mirë është përmes vlerësimit. Vlerësimi tregon se ju nuk e shihni debatin si një përleshje ideologjike rrënuese; humbja e tjetrit nuk është fitimi juaj. Përkundrazi, ju e shihni debatin si një mundësi për zgjidhje të mundshme, dhe edhe nëse kjo nuk mund të arrihet, rritje reciproke dhe mirëkuptim të ri. Një qasje që rekomandon Shapiro është thjeshtë të dëgjoni në fillim të bisedës. Merrni parasysh vlerën që qëndron pas perspektivës së personit tjetër, arsytimin e tyre dhe pse e kanë atë. Edhe nëse përfundimisht



nuk jeni dakord, ka të ngjarë të gjeni diçka që vlerësoni për personin tjetër – qofshin këto vlerat, pasioni, njohuritë mbi temën ose një këndvështrim i nuancuar që nuk e kishit marrë parasysh.

“Nuk ka asgjë më shumë në botë që na pëlqen sesa të ndihemi të vlerësuar. Njihni fuqinë tuaj për t'i vlerësuar ata.” Një qasje më e formalizuar për të kapërcyer këtë pengesë njihet si rregullat e Rapoport. Të krijuara fillimisht nga psikologu matematicien Anatol Rapoport dhe më vonë të sintetizuara nga Daniel Dennett, këto rregulla ofrojnë një udhëzues hap pas hapi për të sjellë vlerësim në një debat.

## Pasi të dëgjoni arsytimin e palës tjetër, ndiqni këto hapa:

Shpjegoni qartë pozicionin e personit tjetër për të treguar se e keni dëgjuar dhe respektuar pozicionin e tij. Përmendni çdo gjë që keni mësuar për t'i treguar personit tjetër se meriton të mësojë dhe se ju e vlerësoni mundësinë. Rendisni pikat për të cilat jeni dakord si një mënyrë për të ulur ato gardhe vetëmbrojtjeje. Dhe tani, ofroni një kritikë ose përgënjeshtrim.

Duke u angazhuar ose në rregullat e Rapoport-it ose në rekomandimin e Shapiro-s, ju demonstroi jo vetëm vlerësim, por gjithashtu ndërtoni besim me personin tjetër. Dhe ju mund ta përdorni atë besim për t'ju shtyrë të kapërceni barrierën përfundimtare.

## Barriera Nr. 3: Injorimi i përkatësisë suaj

Siç e kemi parë, kur mendojmë për dikë si pjesë të grupit tonë, ne jemi më bashkëpunues dhe më të gatshëm ta mendojmë atë si partner dhe jo si pengesë ideologjike. Kur i shohim ata si një anëtar të grupit të jashtëm, ne i shohim si një kundërshtarë. Por sipas Sapolskyt, ne manipulohemi lehtësisht kur bëhet fjalë për të caktuar se kush bën pjesë në ose jashtë grupit tonë. Besoni apo jo, ky është lajmi i mirë. Ne mund të lidhemi me njerëz të tjerë – t'i shoqërojmë ata si pjesë e fisit tonë – bazuar në tipare në dukje të parëndësishme. Mund të jetë aq e thjeshtë sa një hobi i përbashkët, një skuadër sportive e preferuar ose nëse ish shoku i dhomës i kushëririt të tyre të dytë është i diplomuar në Alma Mater. Edhe përkatësia më e dobët mund t'i hapë dyert krijimit të “neve” dhe të reduktojë gardhet duke lehtësuar besnikërinë fisnore.

“Kthejeni personin tjetër nga një kundërshtar në një partner, kështu që nuk do të jem më unë kundër jush, por ne të dy përballemi me të njëjtin problem të përbashkët,” thotë Shapiro. Përkatësia gjithashtu nuk duhet të jetë e parëndësishme. Merrni parasysh debatin e imigracionit në politikën amerikane. Në shumë drejtime, këto debate janë të pazgjidhshme. Realitetet ekonomike janë komplekse, aspiratat humaniste mund të jenë të frikshme për t'u arritur dhe identitetet në çështje të tilla

janë të rrënjosura thellë. Megjithatë, të dhënat e sondazheve sugjerojnë se republikanët dhe demokratët në fakt bien dakord për shumë gjëra. Shumica e të dyja palëve thonë se siguria kufitare, lejimi i qëndrimit të fëmijëve pa dokumente dhe ndihma e refugjatëve civilë për t'i shpëtuar dhunës janë qëllime të rëndësishme. Dallimi është në shkallë dhe intensitet, gjë që zhvendos prioritetet kryesore për secilën palë. Megjithatë, është një gjë të thuash se ke një prioritet të ndryshëm sesa të thuash që të dyja palët nuk kanë fare lidhje me sfidën.

Si i tillë, tejkalimi i kësaj pengese të tretë mund të jetë po aq i thjeshtë sa t'u kujtosh të përfshirëve atë që kanë të përbashkët – qoftë kjo një vlerë, prioritet apo qëllim i përbashkët. Rregullat e Rapoport-it e bëjnë këtë duke renditur pikat e marrëveshjes përpara çështjeve të diskutueshme. Shapiro rekomandon gjithashtu t'i kërkonte personit tjetër të imaginojë zgjidhje që përfshijnë sa më shumë vlera dhe prioritet të përbashkëta.

“Tani, nëse i vini në praktikë këto tre gjëra, kjo mund të transformojnë marrëdhëniet tuaja. Imagjinoni çfarë do të ndodhte nëse do të fillonim një revolucion, por një revolucion pozitiv me mirëkuptim më të madh, vlerësim më të madh, përkatësi më të madhe, si mund ta transformonim politikën, si mund ta transformonim në fund të fundit, botën tonë. Unë besoj se është e mundur, por fillon me secilin prej nesh”, thotë Shapiro. / *business insider – bota.al*



# Shekullori Henry Kissinger: Leksionet e mëdha që ka lënë si trashëgimi



Nga Ahmed CHARAI

Më 27 maj, Henry Kissinger do të festojë ditëlindjen e tij 100-të. Një jetë shumë e gjatë dhe me pasoja të jashtëzakonshme në dy botë shumë konkurruese të diplomacisë dhe ideve. Pasi u largua nga Gjermania naziste, Kissingeri mbërriti në Shtetet e Bashkuara në vitin 1938 si një adoleshent i pasionuar pas librit por pa ndonjë perspektivë të shpejtë në horizont.

Tridhjetë vjet më vonë, ai do të udhëhiqte politikën e jashtme të SHBA-së, fillimisht si këshilltar për sigurinë kombëtare, më pas si Sekretar Shtetit i 2 presidentëve, Richard M. Nixon dhe Gerald R. Ford.

Në vitin 1973, ai bashkë-fitoi Çmimin Nobel për Paqe. Në 4 vitet e tij si Sekretar i Shtetit, ai ndihmoi në dhënien fund të luftës më të diskutueshme të Amerikës, asaj të Vietnamit, e ndau Kinën nga Rusia dhe rishikoi kufijtë e disa shteteve-kombe. Librat e tij, të mbushur me kërkime të kujdesshme dhe argumente të përpunuara, vazhdojnë të

jenë në krye të listës së më të shiturve dhe të tërheqin vëmendjen e liderëve dhe mendimtarëve anembanë botës. Edhe kur kanë kaluar disa dekada

pas largimit nga detyra, ai vazhdon të konsultohet nga drejtorët ekzekutivë, kandidatët presidencialë apo analistët.

Qendra për Studime Strategjike dhe Ndërkombëtare, e kryesuar nga një burrë tjetër i madh, një patriot dhe një nga njerëzit më të ndritur të establishmentit amerikan, John Hamre, organizoi një pritje për nder të Kissinger për të festuar arritjet e tij të jashtëzakonshme. Hamre e filloi fjalimin e tij duke analizuar historinë e dekadave të fundit dhe gjurmën që la Kissinger në të.

Së pari, ishte Lufta e Vietnamit, një konflikt që kishte hyrë në një ngërç. Viti nisi me ofensivën e madhe të Tet-it nga forcat e Vietnamit të Veriut, të cilën Shtetet e Bashkuara e mposhtën duke pësuar edhe vetë humbje serioze. Ne shtator të atij viti, Viet Kongu pushoi së ekzistuari si një forcë e veçantë luftarake, por kjo nuk do të thoshte asnjë fitore për Shtetet e Bashkuara.

Sepse ushtria e Vietnamit të Veriut po bëhej një forcë gjithnjë e më vdekjeprurëse, me divizionet e saj të tankeve që ishin në zgjerim e sipër dhe me avionët sovjetikë dhe raketa anti-ajrore që ishin gjithnjë e më efektive. Për sa kohë që BRSS dhe Kina e mbështetën Veriun, Shtetet e Bashkuara nuk mund ta mposhtnin kurrë atë.

Ai ngërç ishte i dukshëm dhe e

përçau Amerikën. Protestat, si kundër luftës po ashtu edhe pro-luftës e ndanë kombin. Në televizor, amerikanët panë rrënojat e djegura në Saigon dhe djegien e kartave në Seattle. Publiku ishte i lodhur nga lufta. Dhe ishte Kissinger ai që udhëhoqi bisedimet e paqes. Është e vërtetë, që Vietnamit i Jugut kapitulloi në vitin 1975. Por, 2 vjet më parë, ushtria amerikane ishte në gjendje të realizonte një tërheqje të sigurt dhe mbi të gjitha me dinjitet.

Ndërkohë ne i detyrohemi Kissinger për politikën e famshme të frenimit të Bashkimit Sovjetik. Për herë të parë, Shtetet e Bashkuara dhe BRSS ranë dakord të ngadalësojnë ndjeshëm garën e armëve bërthamore. Për pasojë, disa konflikte rajonale u de-përshkallëzuan.

Lufta bërthamore u shmang dhe u kursyen miliona jetë njerëzish në Azinë Juglindore, Afrikën Jugore dhe midis ishujve të Paqësorit, pra në çdo vend ku guerilët komunistë luftuan me shtetet pasuese të fuqive koloniale.

Për të forcuar pozicionin e Amerikës në Azi, administrata Nixon arriti një afrim diplomatik me Kinën kontinentale, nga e cila Shtetet e Bashkuara ishin distancuar që nga viti 1949, kur komunistët morën pushtetin. Për të vulosur marrëdhënien e re,

Nixon zhvilloi një udhëtim spektakolar në Kinë në shkurt 1972.

Pas 6 tetorit 1973, zyrtarët izraelitë i telefonuan Kissinger për t'i thënë se po përballeshin me një pushtim. Forcat egjiptiane po sulmonin në Gadishullin e Sinait, ndërsa ushtria siriane ishte në veri të Izraelit. Sapo kishte nisur e ashtuquajtura Lufta e Katërt Arabo-Izraelite. Nixon e dërgoi Kissinger për të negociuar me Izraelin, Egjiptin dhe Sirinë, dhe ndodhi ajo që hyri në histori si "diplomacia e anijes kozmike". Në fund pati një paqe të re dhe këtë herë të qëndrueshme. Ajo i shërbeu disa interesave të rëndësishme amerikane: ndaloi ciklin e pushtimeve, ndaloi embargon nga shtetet arabe eksportuese të naftës dhe krijoi terrenin për një traktat historik paqeje midis Izraelit dhe Egjiptit (Marrëveshja e Camp David e presidencës Carter).

Kissinger mund të jetë i vetmi fitues i çmimit Nobel për Paqe, që ka siguruar më shumë paqe pas fitimit të çmimit se sa më herët. Këto suksese e bëjnë atë një diplomat me një staturë historike. Intensiteti dhe shtrirja e këtyre nismave diplomatike dhe suksesi i tyre – në kuptimin që të gjitha prodhuan marrëveshje – nuk kanë asnjë paralele në historinë amerikane dhe ndoshta as në

historinë e Izraelit.


Me mrekullitë e tij në fushën e diplomacisë, Kissinger la gjurmë në shekullin XX-të. Ndërsa e pranon se profetët kanë "vizionin më të pasionuar", Kissinger thotë se preferon më shumë shtetarët, pasi ata i njohin realitetet në terren dhe mund të shohin vlerë në përfitimet në rritje.

Mjerisht, klima politike aktuale nuk inkurajon shfaqjen e liderëve si Kissinger. Libri i tij kushtuar "udhëheqjes", tregon rëndësinë që ka ndërtimi i konsensusit për çështjet kryesore. Një udhëheqës politik nuk mund të zhvillojë një vizion që i jep statusin e një burri shteti, duke postuar në Twitter apo Facebook.

Përkundrazi, siç shkruan Kissinger, udhëheqësit lindin nga studimi i kujdesshëm i historisë. Të gjitha demokracitë vuajnë nga e njëjta sëmundje: Një klasë politike e varfër intelektualisht, e cila është më e fiksuar pas sondazheve dhe rrjeteve sociale sesa nga një vizion për shoqëritë e tyre.

Por ky është një problem, të cilin duhet ta marrin në konsideratë edhe mendimtarët që mendojnë sot për nesër: Si mund të vazhdojë Amerika ta udhëheqë botën pa liderë që mund të kombinonjë teorinë e lartë dhe pragmatizmin e bazuar, siç bën Kissinger? / "National Interest" – Bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Peja mposhti Trepçën, kampioni vendoset në ndeshjen e pestë

Pejë, 14 maj - Në një super dramë të zhvilluar në "Karagaçi", Peja ka mundur Trepçën 87:83 (30:26, 23:22, 18:17, 16:18). "Verdhezinjtë" kanë barazuar serinë finale në

2:2 dhe kampioni do të vendoset në ndeshjen e pestë, që do të zhvillohet në "Minatori". Ndeshja gjatë gjithë ndeshjes ka qenë e baraspeshuar, ku fituesi është

vendosur në sekondat e fundit, e ku pejanët ishin më të mirë dhe më të vëmendshëm, duke triumfuar 87:83, për të bërë që kampioni të vendoset në Mitrovicë. Brad Waldow dhe

Jalen Tate ishin më të mirët të vendasit me 14 pikë e dhjetë kërcime, përkatësisht 27 pikë, ndërsa te mysafirët më i miri ishte Drilon Hajrizi me 24 pikë e gjashtë kërcime.



## Ballkani rikthehet në pozitën e liderit

Barazimin e Dritës kundër Gjilanit e ka shfrytëzuar për mrekulli skuadra e Ballkanit, e cila me fitoren ndaj Llapit ka arritur të rikthehet në krye të tabelës në Superligë. Tash suharekasit e kanë shumë më të lehtë të mbrojnë titullin e kampionit

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 14 MAJ - Skuadra e Ballkanit për mrekulli e ka shfrytëzuar gabimin e Dritës dhe është rikthyer në pozitën e parë në renditjen e Albi Mall Superligës së Kosovës në futboll, dy javë para përfundimit të kampionatit. Skuadra nga Suhareka të dielën ka shënuar fitore para tifozëve të vet, në javën e 34-t në duel me Llapin (1-0). Golin e vetëm në ndeshje e shënoi sulmuesi Albion Rrahmani, me gjuajtje me kokë, në minutën e 29-të. Në anën tjetër, Drita nuk ka arritur të marrë më shumë se një pikë në përballje me rivalin lokal, Gjilanin (1-1). Rron Broja e kaloi Dritën në epërsi, në pjesën e parë me një gol të shkëlqyeshëm, por shifrat i barazoi Mevlan Zeka nga

penalltia, në minutën e 82-të. Pas këtij barazimi Drita bie në pozitën e dytë, me 67 pikë dhe tani ka dy pikë më pak se Ballkani. Ndërsa skuadra që po shkëlqen në ndeshjet e fundit është Dukagjini i Klinës që është ngjitur në pozitën e katërt në renditje, pas fitores bindëse ndaj Drenicës në Skenderaj, me shifrat 4-1. Golat për skuadrën nga Klina i shënuan Marcei Santosit (16', 30'), Altin Merlakut (20') dhe Granit Elezajt (45'+), derisa golin e vetëm për kuqezinjtë e Skenderajt e shënoi Gentian Imeri (35'). Pikë të rëndësishme në garën për mbijetesë në elitë ka arkëtuar Malisheva, e cila në shtëpi ka barazuar me Prishtinën (1-1). Kryeqytetasit kaluan në epërsi në minutën e 61-të nëpërmjet Mërgim Pefqelit, por shifrat i barazoi Bleart Tolaj, në



minutën e 79-të. Ndërkohë, Ferizaj ka shënuar fitore tejet të rëndësishme në duel me rivalin direkt për mbijetesë, Trepçën '89, me rezultat 1-0. Golin e tri pikëve të mëdha për ferizajasit e shënoi Albin Krasniqi në minutën e 53-të.

Pas kësaj fitoreje, Ferizaj është ngjitur në pozitën e tetë, e cila siguron ndeshjen e barazhit, me 38 pikë, derisa mitrovicasit tani ndodhet në pozitën e parafundit, me 37 pikë, pozitë kjo që dërgon në një rang më të ulët të garave.

### SUPERLIGA

Gjilani-Drita	1-1
Ballkani-Llapi	1-0
Malisheva-Prishtina	1-1
Ferizaj-Trepça '89	1-0
Dukagjini-Drenica	4-1

### Tabela

	Pikë
1. Ballkani	69
2. Drita	67
3. Gjilani	52
4. Dukagjini	47
5. Prishtina	45
6. Llapi	42
7. Malisheva	40
8. Ferizaj	38
9. Trepça '89	37
10. Drenica	23

**KF Fushë Kosova është anëtare e re e Albi Mall Superligës. Barazimi 2:2 në ndeshjen e javës së 26-të në shtëpi kundër Ramiz Sadikut i ka mjaftuar kësaj skuadre që ta festojë titullin e kampionit në Grupin B të Viva Fresh Ligës së Parë, një javë para përfundimit të edicionit, pasi ka ruajtur epërsinë e paarritshme ndaj skuadrës së dytë në renditje, Ulpianës. Do theksuar se Fushë Kosova rikthehet në Superligë pas thujse një dekade, kurse festa për këtë sukses ishte e jashtëzakonshme, e ku nuk munguan as lotët e gëzimit. Ndërkohë, në Grupin A, kampioni do të vendoset në ndeshjet e javës së fundit, e në garë për titull dhe inkuadrim në elitë janë Feronikeli '74 dhe Liria.**

## Trepça dhe Besa kualifikohen në finale

### "Epoka e re"

PRISHTINË, 14 MAJ - KH Trepça është finalistja e parë e plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Trepça në gjysmëfinale ka shënuar dy fitore ndaj Prishtinës. Fitoren e dytë dhe vendimtare, skuadra mitrovicase e arriti të dielën në kryeqytet. Ndeshja dramatike përfundoi 32:31 në të mirë të Trepçës. Golin e fitores e shënoi Deniz Terziqi në minutën e 59-të. Te rezultati 31:31, Oltion Beshiri i



Prishtinës nuk realizoi penallti. Prishtina e nisi më mirë ndeshjen dhe ishte në epërsi deri në minutën e 25-të. Epërsia e Prishtinës në disa

raste ishte tri gola. Në pesë minutat e fundit të pjesës së parë Trepça kishte më shumë nga loja dhe shkoi në pushim me epërsi 15:14. 18:14 u rrit epërsia në pjesën e dytë në të mirë të mitrovicasve. Prishtina u afrua ngadalë dhe barazoi në 26:26 në minutën e 47-të. Më pas u luajt për secilin gol, por në fund më të koncentruar ishin mysafirët që shënuan fitore. Terziqi e Yassine Henahen i shënuan nga shtatë gola për Trepçën. Shpëtim Mehmeti i kishte gjashtë, ndërsa Lulzim

Shabani pesë. Kontribut në fitore dhanë edhe portierët. Sergio Barreto i shënoi dhjetë gola për Prishtinën. Gjashtë i kishte Albi Gjuka, ndërsa pesë i shënoi Rron Ramadani. Katër gola i shënoi kapiteni Oltion Beshiri. Besa Famgas është kualifikuar në finale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Të dielën hendbollistët e Besës së Pejës fituan bindshëm në Vushtri me rezultat 32:24. Besa Famgas e kishte fituar bindshëm edhe ndeshjen e

parë ndaj Vushtrrisë, të luajtur në Pejë. Dhe me rezultat 2:0 kalon në finale. Denis Shabanoviq ishte më efikas te Besa me tetë gola. Nga pesë i kishin Nikola Prce e Arbios Mushkolaj. Te Vushtria, tetë gola i shënoi Nemanja Drakuloviq, ndërsa pesë i kishte Felipe Teixeira. Besa në finale të plejofit luan me Trepçën. E synon titullin e radhës. Ndaj Vushtrrisë të dielën, Besa Famgas nisi herët shkëputjen dhe më pas ka mbajtur epërsi të lartë deri në fund të ndeshjes.

## Barcelona edhe matematikisht siguron titullin

BARCELONË, 14 MAJ - Barcelona e ka fituar titullin e 27 në La Liga, katër xhiro pa përfunduar sezoni. Xavi Hernandez e ka fituar titullin e parë kampion në La Liga si trajner i kësaj skuadre. Me fitoren bindëse 1-4 në udhëtim ndaj Espanyolit, katalonasit edhe matematikisht

e kanë siguruar titullin e kampionit, të parin që nga sezoni 2018/19. Lewandowski kaloi mysafirët në epërsi në minutën e 11-të, para se Balde të dyfishonte nëntë minuta më vonë. Ishte sërish sulmuesi polak që realizoi golin e tij të dytë personal dhe të tretin në

përgjithësi për Barcelonën në minutën e 40-të. Kounde realizoi në të 53-tën për rezultat 0-4. Në minutën e 74-të Espanyoli shënoi për 1-4 nëpërmjet Puado. Krejt në sekondat e fundit, Espanyoli shënoi edhe njëherë, për rezultat përfundimtar, 2-4. Me

këtë fitore, Barcelona shkon në kuotën e 85 pikëve në vendin e parë, 14 më shumë se Real Madridi, katër xhiro para fundit të kampionatit. Në anën tjetër, Espanyol mbetet i parafundit me 31 pikë dhe e rrezikon seriozisht largimin nga elita e futbollit spanjoll.





**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Departamenti për Burime Njerëzore



07/1-01 SAP-R/519/2023  
Datë 12.05.2023

Në bazë të Ligjit për Policinë, kreu V, neni 44, Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, kreu II, neni 8, Ligji për Barazi Gjinore nr. 05/L-020, neni 5 dhe 6, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi nr. 05/L-021, neni 7, Udhëzimin Administrativ 01/2021 mbi Marrëdhënien e Punës në Policinë e Kosovës, kapitulli III neni 8, neni 9 pika 1 dhe 2, dhe aprovimin e Drejtorit të Përgjithshëm datë: 18/04/2023 me nr ref: DBN 07/025/2023, Policia e Kosovës:

### VAZHDON AFATIN E KONKURISIT

Të publikuar nga data 19.04.2023 deri me datë 12.05.2023 me nr reference 07/1-01 SAP-R/516/2023 për pranimin e zyrtarëve policorë sipas kushteve të parapara të konkurrimit për të gjitha minoritetet (Serb, Boshnjak, Turq, Goran, Romë, Ashkali, Egjiptas, Kroat, Malazez, Maqedonas ).

**Titulli i vendit të punës: Zyrtar Policor**

**Vendi i punës : Drejtoria Rajonale e Policisë Mitrovicë Veri**

Afati për paraqitjen e aplikacioneve vazhdohet për tetëmbëdhjetë (18) ditë duke filluar nga data

**13.05.2023** deri me datë **30.05.2023**.

**Vëmendje: Kriteret në konkurs mbeten të njëjta si dhe kandidatët të cilët kanë konkurruar në këtë konkurs nuk është e nevojshme të aplikojnë përsëri.**

Formularët për aplikim mund të merren në zyrat e personelit të drejtorive rajonale, në stacionet policore, ose të tërhiqen nga ueb faqja e PK-së: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com). Aplikacioni për konkurrim duhet të dorëzohet së bashku me kopjet e dëshmimeve të kërkuara personalisht në zyrën e personelit pranë drejtorive rajonale në Prishtinë, Mitrovicë Jugu, Pejë, Prizren, Ferizaj, Gjilan, Mitrovicë Veri dhe Gjakovë, çdo ditë pune prej orës **09:00-15:00**.



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme - Ministarstvo Unutrašnjih Poslova  
Ministry of Internal Affairs

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë/Prishtinë  
Generalna Policijska Direkcija/General Police Directorate

Uprava za Ljudske Izvore



07/1-01 SAP-R/519/2023  
Datë 12.05.2023

Na osnovu Zakona o Policiji, poglavlje V, član 44, Zakona o radu br. 03/L-212, poglavlje II, član 8, Zakon o ravnopravnosti polova br. 05/L-020, član 5 i 6, Zakona o zaštiti od diskriminacije Br. 05/L-021, član 7, Administrativno Uputstvo 01/2021 o Radnom Odnosu u Policiji Kosova, poglavlje III član 8, član 9, tačka 1 i 2, i usvajanjem Generalnog Direktora od 18/04/2023 pod br ref: DBN 07/025/2023, Policia Kosova:

### PRODUŽENJE ROKA KONKURSA

Objavljen od 19.04.2023 do 12.05.2023.godine, sa br. referencije 07/1-01 SAP-R/516/2023 za prijem policijskih službenika po prethodnim uslovima konkursa za sve manjine (Srbe, Bošnjake, Turaka, Goranaca, Roma, Aškalije, Egipćane, Hrvate, Crnogorce, i Makedonce).

**Naziv radnog mesta: Policijski službenik**

**Radno mesto: Regionalna Direkcija Mitrovica -Sever**

Rok za prijavu aplikacija produžava se za osamnaest (18) dana, počev od **13.05.2023. do 30.05.2023.** godine.

**Pažnja: Kriterijumi na konkursu ostaju isti, i kandidati koji su konkurisali na ovom konkursu ne moraju da se ponovo prijave .**

Formulare za apliciranje mogu se uzeti u kancelarijama osoblja Regionalnih Direkcija, u Stanicama Policije, ili da se preuzimaju iz ueb stranice PK-a: [www.kosovopolic.com](http://www.kosovopolic.com). Aplikacija za konkurisanje treba da se preda lično zajedno sa kopijama potrebnih dokaza u kancelariji osoblja Regionalne Direkcije Priština, Mitrovica Jugu, Peć, Prizren, Uroševac, Gnjilane, Mitrovica Sever i Djakovica, svakog radnog dana od **09:00-15:00.časova**.

